



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI**

VENDIM

Nr. 137, datë 28.09.2017

PËR

**DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN NR. 127, DATË 06.10.2011
“MBI PËRMBAJTJEN E DETYRUESHME, AFATET DHE FORMËN E RAPORTEVE
TË SIPËRMARRJEVE TË INVESTIMEVE KOLEKTIVE, SHOQËRIVE TË
ADMINISTRIMIT DHE DEPOZITARËVE”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 2, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, me propozim të Drejtorisë së Mbikëqyrjes të Tregut të Fondeve të Pensioneve, të Fondeve të Investimeve dhe të Titujve, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

1. Miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren nr. 127, datë 06.10.2011 “Mbi përmbajtjen e detyrueshme, afatet dhe formën e raporteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive të administrimit dhe depozitarëve”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR
Pajtim MELANI

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI

Në Rregulloren nr. 127, datë 06.10.2011 “Mbi përmbajtjen e detyrueshme, afatet dhe formën e raporteve të sipërmarrjeve të investimeve kolektive, shoqërive të administrimit dhe depozitarëve”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Në nenin 10:

a) Në pikën 2, shprehja “deri më 31 janar të vitit pasardhës”, zëvendësohet me shprehjen “deri më 15 janar të vitit pasardhës”.

b) Në pikën 3:

- i. Në shkronjën “a”, shprehja “deri në 30 prill të vitit aktual”, zëvendësohet me shprehjen “deri më 15 prill të vitit aktual”.
- ii. Në shkronjën “b”, shprehja “deri më 31 korrik të vitit aktual”, zëvendësohet me shprehjen “deri më 15 korrik të vitit aktual”.
- iii. Në shkronjën “c”, shprehja “deri më 31 tetor të vitit aktual”, zëvendësohet me shprehjen “deri më 15 tetor të vitit aktual”

2. Në nenin 11:

a) pika 1, ndryshon si vijon:

“1. Pasqyrat financiare duhet të paraqiten në formë shkresore pranë Autoritetit, si dhe në formë elektronike në format excel dhe pdf pranë departamentit përkatës të Autoritetit brenda afateve të referuara në nenin 10, paragrafi 2 dhe 3 të kësaj rregulloreje.”

b) pika 2, ndryshon si vijon:

“2. Shoqëritë e administrimit duhet të depozitojnë me shkrim në Autoritet, brenda afatit të referuar në nenin 10, paragrafi 1 të kësaj rregulloreje, si më poshtë...”

3. Në nenin 16:

a) pika 2, ndryshon si vijon:

- i. Në shkronjën “a”, shprehja “deri në 30 prill të vitit aktual”, zëvendësohet me shprehjen “deri më 15 prill të vitit aktual”.
- ii. në shkronjën “b”, shprehja “deri më 31 korrik të vitit aktual”, zëvendësohet me shprehjen “deri më 15 korrik të vitit aktual”.
- iii. Në shkronjën “c”, shprehja “deri më 31 tetor të vitit aktual”, zëvendësohet me shprehjen “deri më 15 tetor të vitit aktual”.

b) Në pikën 3, shprehja “është 31 janari i vitit pasardhës”, zëvendësohet me shprehjen “është 15 janari i vitit pasardhës”.

4. Në nenin 17:

a) Pika 1, ndryshon si vijon:

“1. Pasqyrat financiare duhet të paraqiten në formë shkresore pranë Autoritetit, si dhe në formë elektronike në format excel dhe pdf pranë departamentit përkatës të Autoritetit brenda afateve të referuara në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 16 të kësaj rregulloreje.”

b) Pika 2, ndryshon si vijon:

“2. Shoqëritë administruese duhet të depozitojnë me shkrim në Autoritet, për fondet e investimeve, brenda afatit të referuar në nenin 16, paragrafi 4 të kësaj rregulloreje, si më poshtë...”

5. Në nenin 22:

a) pika 2, ndryshon si vijon:

- i.Në shkronjën “a”, shprehja “deri në 30 prill të vitit aktual”, zëvendësohet me shprehjen “deri më 15 prill të vitit aktual”.
- ii.Në shkronjën “b”, shprehja “deri më 31 korrik të vitit aktual”, zëvendësohet me shprehjen “deri më 15 korrik të vitit aktual”.
- iii.Në shkronjën “c”, shprehja “deri më 31 tetor të vitit aktual”, zëvendësohet me shprehjen “deri më 15 tetor të vitit aktual”.

- b) Në pikën 3, shprehja “është 31 janari i vitit pasardhës”, zëvendësohet me shprehjen “është 15 janari i vitit pasardhës”.

6. Në nenin 23:

a) Pika 1, ndryshon si vijon:

“1. Pasqyrat financiare duhet të paraqiten në formë shkresore pranë Autoritetit, si dhe në formë elektronike në format exceli dhe pdf pranë departamentit përkatës të Autoritetit brenda afateve të referuara në paragrafët 2 dhe 3 të nenit 22 të kësaj rregulloreje.”

b) Pika 2, ndryshon si vijon:

“2. Shoqëria e investimit duhet të depozitojë me shkrim në Autoritet, brenda afatit të referuar në nenin 22, paragrafi 4 të kësaj rregulloreje, si më poshtë...”

7. Në nenin 26, pika 3 ndryshon si vijon:

“3. Shoqëria administruese e fondit të investimit për secilin fond nën administrim, duhet të raportojë çdo dy javë, brenda dy ditë pune pas përfundimit të periudhës dy javore për të cilën do të raportohet informacioni i përcaktuar në pikën 2, të nenit 25 të kësaj rregulloreje.”